

Investimet kapitale në fushën e shëndetësisë

Në aspektin e infrastrukturës së objekteve, në shërbim të kujdesit parësor shëndetësor, gjatë vitit 2008 janë parapërgatitur projektet për fillimin e ndërtimit të QMF në lagjen e Vreshtave, lagjen e Arbërisë, lagjen e Velanisë, lagjen e Muhagjerëve dhe fshatin Hajvali. Punimet kanë filluar në të gjitha lokalitetet e përmendura përveç lagjes së Muhagjerëve, ku mbetet që në fillim të vitit 2009 të përgatitet projekti komfor kërkesave aktuale të Komunës së Prishtinës. Për nevojat e ENSH janë blerë dy autoambulanca të reja dhe është përfunduar tenderimi i pajisjeve mjekësore laboratorike për nevojat e QMF-ve.

DSHMS ka hartuar projekte kapitale për konferencën e donatorëve (Spitali i qytetit, Shtëpia e pleqve dhe Qendra për trajtimin e sëmurëve të rëndë).